

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

URDHRI I FARMACISTËVE

KËSHILLI KOMBËTAR

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve, në mbledhjen e tij të datës **29.05.2015**, në zbatim të nenit 11 pika 4 te Ligjit Nr.9150 Datë 30.10.2003 «Për Urdhrin Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë» si dhe nenit 25, pika 5 të “Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë”, miratoi ndryshimet e mëposhtme në statut:

Neni 6 (paragrafi 3 ndryshohet si mëposhtë)

Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të farmacistit në sektorin farmaceutik të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të antarësohen në Urdhër, të njohin dhe të zbatojnë Kodin Deontologjik Farmaceutik Shqiptar, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin farmaceutik dhe atë shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, të paraqesin dëshminë e provimit të kualifikimit në gjuhën shqipe nga institucionet përkatëse të licensuara dhe të njohura nga Ministria e Arsimit si dhe ti nënshtrohet një testimi me gojë nga Komisioni i Regjistrimit dhe i Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit pranë Urdhrit të Farmacistëve.

Neni 18 (Pas pikës 3 shtohen pikat e mëposhtme)

4. Vërtetohet se farmacisti ka përdorur dokumente të fallcifikuara për të marrë lejen e ushtrimit të profesionit të farmacistit.
5. Vuan nga një sëmundje e rëndë (mendore e te tjera, e vërtetuar me raport mjeko ligjor) ose dëmtime të rënda fizike, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin normal të profesionit.

Neni 19 (paragrafi i dytë shtohet fjala e mëposhtme)

Me Leje Ushtrimi Profesionit pajiset çdo farmacist i anëtar aktiv **vetëm në Urdhrin e Farmacistëve** dhe çdo ndihmës farmacist i regjistruar në Regjistrin e Veçantë të ndihmës farmacistëve.

(Shtohet paragrafi i mëposhtëm)

Cdo anëtar i Urdhrit të Farmacistëve mund të aplikojë për të qenë drejtues teknik nëse plotëson parakushtet e vendosura në Ligjin “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik” si dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të jetë anëtar aktiv vetëm i Urdhrit të Farmacistëve.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore sipas parashikimeve të nenit 18 pika d) dhe e) të ligjit 9150 “Për Urdhrin e Farmacistëve” brenda një periudhë 3 vjecare.
- Të mos vuaj nga probleme shëndetësore që e bëjnë të pa mundur ushtrimin e profesionit.
- Të punojë me kohë të plotë vetëm në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik.
- Të mos ketë mbushur moshën për pension, përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve.
- Të plotësojë dispozitat e Kodit të Punës për sa i përket prezencës së tij në subjektin farmaceutik.
- Nuk është duke ushtruar një detyrë tjetër publike e cila përbën konflikt interesi sipas ligjit “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”
- Në rastet e dypunësimit, për drejtuesin teknik, dypunësimi do të lejohet vetëm brenda qytetit.

Të drejtën për dhënien dhe heqjen e lejës për ushtrimin e profesionit si drejtues teknik e ka Komisioni i Regjistrimit dhe i Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit”

Drejtuesit teknik i pezullohet leja për ushtrimin e profesionit si drejtues teknik në mënyrë të menjëhershme:

- a) Kur në farmaci gjendet duke shërbyer një person jo farmacist.
- b) Kur deklaratat e bëra tek formulari i ndryshimeve janë të rreme.
- c) Kur në farmaci gjendet, në mënyrë të përsëritur, duke shërbyer një farmacist pa qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.

Pezullimi në mënyrë të menjëhershme i lejës për ushtrimin e profesionit për rastet e parashikuara në pikat a) dhe b) bëhet për një periudhë 3 vjecare, kurse për rastin e parashikuar në pikën c) pezullimi i lejës për ushtrimin e profesionit bëhet për një periudhë 1 vit. Ankimi ndaj këtyre masave bëhet brenda 30 ditëve drejtpërsëdrejti në gjykatë.

Në rastin kur subjekti farmaceutik ushtron aktivitetin pa patur të punësuar një drejtues teknik, farmacistit të punësuar në këtë farmaci i pezullohet licenca deri në momentin e paisjes së farmacisë me drejtues teknik.

Në rastin kur pronar i subjektit farmaceutik nuk është farmacisti, pronari i farmacisë duhet të nënshkruajë një deklaratë pranë Urdhrit të Farmacistëve, ku të deklarojë se ai personalisht nuk do të ndikojë në ushtrimin e veprimtarisë profesionale të drejtuesit teknik apo farmacistit në farmacinë që ai ka në pronësi.

Neni 21 (pas pikës 5 shtohet pika 6 si mëposhtë)

- Të paraqesë pranë Urdhrit fotokopje të ID ose pasaportës si dhe të deklarojë pranë zyrave qendrore të Urdhrit të gjitha ndryshimet, që lidhen me ushtrimin e profesionit si: Emri, Mbiemri, Nr.tel, e-mail, emrin dhe adresën e subjektit ku ushtron profesionin si dhe kopje të genplanit dhe planvendosjen e tij.

Neni 48 (paragrafi i dytë ndryshohet si mëposhtë)

- Shlyerja e kuotizacionit është e detyrueshme dhe kushtëzon anëtarësinë në Urdhër. Detyrimi për pagesën e kuotizacionit është detyrim mujorë dhe duhet të paguhet brenda vitit kalendarik.
- Afati i fundit i pageses së kuotizacionit është muaji Mars i vitit pasardhës. Mospagimi i detyrimit të kuotizacionit përbën shkelje, me pasojë pezullimin e menjëhershëm të lejes së ushtrimit të profesionit deri në pagimin e plotë të detyrimit.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.07.2015.

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve, në mbledhjen e tij të datës **29.05.2015**, në zbatim të nenit 11 pika 4 të Ligjit Nr.9150 Datë 30.10.2003 «Për Urdhrin Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë» si dhe nenit 25, pika 5 të «Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë», vendosi:

- 1-Të Miratojë dhënien e Lejes së Ushtrimit të Profesionit për Nd/Farmacistët si të punësuar dhe Drejtues Teknik në Agjensitë Farmaceutike me vlefshmëri deri me 31.12.2015.
- 2- Vlefshmëria e Lejes së Ushtrimit të Profesionit për Nd/Farmacistët si Drejtues Teknik në Agjensitë Farmaceutike pas datës 31.12.2015, do të behet në baze të akteve Ligjore e nënligjore në fuqi.
- 3-Ngarkohet Sektori i regjistrimit për zbatimin e këtij urdhri.

1-Të perjashtojë nga detyrimi i tarifës prej 5.000 lekë për leje ushtrimi profesioni për anetarët e regjistruar gjatë periudhës 01.01.2015 deri më 30.06.2015 për herë të parë.

2-Të gjitha rastet e përfshira në pikën 1 të këtij vendimi për pajisje me Leje të Ushtrimit të Profesionit me date 01.07.2015 do të paguajnë vlerën prej 1000 lekë, sipas pikës nr. 3 të VKK nr. 4, datë 03.12.2014.

- 3-Teprica kreditore prej 4.000 lekë të njihet si pagese për kuotat për periudhen ne vazhdim.
4-Ngarkohet Sektori i Financës për zbatimin e këtij urdhri.

- 1- Tarifa për cdo faqe dokumentacioni që lëshohet nga Urdhri i Farmacistëve, sipas Ligjit “Për të Drejtën e Informimit në RSH” është 500 lekë.
2- Pagesa duhet të paguhet në llogaritë bankare të Urdhrit paraprakisht.

Ky vendim hyn në fuqi me datë 01.07.2015